



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR ISHSËM

VENDIM

Nr.13, datë 20.10.2022

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT, PËR QËLLIME TË NDRYSHME (SANITARE), TË SUBJEKTIT “TURGUT OZAL EDUCATION” SH.A, ME VENDNDODHJE, RRUGA BERNARDIN PALAJ, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të shoqërisë “Turgut Ozal Education” sh.a, “Kërkesë për leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit, për qëllime të ndryshme (sanitare), me vendndodhje, rruga Bernardin Palaj, bashkia Tiranë.
2. Treguesit paraparak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH)

-X=482141; Y=4575760; Z=104 m.m.n.d

Prurja e ujit të kërkuar: Q=0.3 l/sek

Thehtësia e pus-shpimit: 160 m

Thehtësia e vendosjes së pompës : 80m

Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)

-X=482191; Y=4575789; Z=104 m.m.n.d

Koordinatat e pikës së shikimit (KRGJSH)

-X=482101; Y=4575790; Z=105 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

